

UDHËZIM
Nr.24, datë 6.3.2009

PËR PËRCAKTIMIN E EKSTREMITETEVE TË PULLAVE TË SIGURISË

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 pika 7 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Ekstremitetet e pullës së rregullsisë që lëshohen dhe vendosen te çdo makinë nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (NJMLF) janë si më poshtë:

a) Pullat e sigurisë duhet të kenë përmasat e nevojshme, 35*35mm, për të mbyllur kapakun e memories së makinave në mënyrë që të mos manipulohet.

b) Të kenë ngjitës extra të fortë.

c) Numrin serial progresiv.

ç) Holograma të jetë me ndryshim ngjyrash nga pjerësimi dhe me mikrotekst "Ministria e Financave" dhe shqiponja. Mikroteksti "Ministria e Financave" dhe "shqiponja" të jenë të gdhendura me lazer "laser engrave". Këto specifikime miratohen në kontratën që lidhet nga NJMLF me Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë.

d) Emrin e kodit të llojit të certifikatës dhe viti i verifikimit.

dh) Sfondi, forma, ngjyrat dhe lloji i shkrimit, dhe elemente të tjera përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

2. Vlefshmëria e pullave të sigurisë është njëvjeçare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode